

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Plagosja e avokatit në mes të lokalit/ Dhoma e Avokatisë Durrës bojkoton për dy orë seancat gjyqësore: Kërkojmë hetim të plotë të rastit dhe rritje të sigurisë për avokatët
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/plagosja-e-avokatit-ne-mes-te-lokalit-dhoma-e-avokatisë-durr-es-bojkot-i514794
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:13:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 08:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f9b06d585c9b657c8e24b2e1e7a080065aece8176652db18e72fea7650873c5
TEKSTI	3159725a8f7ea3203f804d692d2d8e88196673d283d6544045002057587ccfb3
PAMJA	4b89737f42f4adfa955249fa0df16dc78511041a517fd244242734ca5f2cf564

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d8e47ed94855f9b7e8f46aa006aee10edfcf58d1c422e4421a12d373c97f6be0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d8e47ed94855f9b7e8f46aa006aee10edfcf58d1c422e4421a12d373c97f6be0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

15 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

20 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

1 DITE ME PARE

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

Aktualitet

Plagosja e avokatit në mes të lokalit/ Dhoma e Avokatisë Durrës bojkoton për dy orë seancat gjyqësore: Kërkojmë hetim të plotë të rastit dhe rritje të sigurisë për avokatët

Nga ana tjetër, avokatët i kanë kërkuar strukturave të policisë së Durrësit më shumë informacion në lidhje me këtë rast, si dhe ecurinë e ndjekur deri tani.



18 Shtator 2026, 10:57
Nga E.d



Foto ilustruese

DURRËS- Avokatët në Durrës kanë bojkotuar për dy orë seancat gjyqësore të cilat do të zhvilloheshin ditën e sotme, në shenjë proteste pas plagosjes me armë të avokatit Elton Shllaku. Shllaku u plagos dy ditë më parë, pas një konflikti banal në një lokal në lagjen nr. 1 të qytetit të Durrësit.

Në kuadër të kësaj, Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës vendosi të pezullojë pjesëmarrjen në seanca nga ora 08:00 deri në 10:00. Ata kërkuar rritje të sigurisë për avokatët gjatë ushtrimit të detyrës. Vendimi, i firmosur më 17 shtator, i është drejtuar edhe Prokurorisë dhe Policisë së Durrësit dhe i kërkohej një hetim i shpejtë për zbardhjen e rethanave të ngjarjes, si dhe vënien e autorit përballë përgjegjësisë ligjore.

Nga ana tjetër, avokatët i kanë kërkuar strukturave të policisë së Durrësit më shumë informacion në lidhje me këtë rast, si dhe ecurinë e ndjekur deri tani. Avokati Elton Shllaku u qëllua me armë dy ditë më parë, në një lokal në shëtitoren "Taulantia" në Durrës. Policia vijon kërkimet për kapjen e autorit të dyshuar, Fatmir Ferhati./Dosja.al



editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 10:36

"O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke"/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

Vendim nr.74 datë 17.09.2026

Komiteti Drejtues i Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës, së bashku me anëtarët e Kryesisë së Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës në Këshillin e Përgjithshëm, pasi u njohën me ngjarjen e rëndë të ndodhur ndaj kolegut, Av. Elton Shllaku, dhe pasi, në një mbledhje urgjente, shqyrtuan informacionet e marra nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, sipas të cilave motivi i konfliktit lidhet me një konflikt gjyqësor pronësie, duke e konsideruar këtë ngjarje si të lidhur me ushtrimin e detyrës profesionale të avokatit dhe duke vlerësuar edhe një herë se siguria dhe jeta e avokatëve gjatë ushtrimit të profesionit kërkojnë vëmendje dhe mbrojtje të posaçme institucionale, në shenjë solidariteti dhe sensibilizimi,

VENDOSI

1. Bojkotimin e seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në të dy seksionet, civile dhe penale, nga ora 08:00 deri në orën 10:00, në shenjë solidariteti me kolegun Av. Elton Shllaku.
2. T'i drejtohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, znj. Suela Beluli, me kërkesën për zhvillimin e një hetimi sa më të shpejtë, të plotë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës.
3. T'i drejtohet Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, z. Ervin Hodaj, me kërkesën për informacion të mëtejshëm lidhur me rrethanat e ngjarjes, si dhe për marrjen e të gjitha masave të nevojshme në kuadër të kompetencave ligjore për zbardhjen e saj.
4. Nga ky bojkot dyorësh përjashtohen seancat gjyqësore që kanë objekt shqyrtimin e masave të sigurimit.
5. Të njoftohet Komiteti Drejtues i Dhomës së Avokatisë Tiranë për këtë situatë dhe çështja e sigurisë së avokatëve gjatë ushtrimit të profesionit t'i referohet mbledhjes së radhës së Këshillit të Përgjithshëm.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës

Av. Lorval PETANI

(Signature of Av. Lorval PETANI)

durrës

avokatët

bojkot

Sondazh

Poll

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

më të klikuarat

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Hetimet për nënshkrimin e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditë Latinopoulou

Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagan Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Aktualitet

18 Shtator 2026, 10:36

“O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke”/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

Pamje DURRËS- Vendim i i Gjykatës Speciale në Hagë, e cila dënoi me 81 vite burg në totoa katër ish-krerët e U&Cce...

Haga dënoi me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së/ Prishtina ngrihet sot në protestë, policia shton masat e sigurisë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 10:14

U ndaluan pas tensioneve në tubimin e djeshëm, lirohen 25 të ndaluarit

Aktualitet

18 Shtator 2026, 09:26

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

Aktualitet

18 Shtator 2026, 09:22

Blokimi i pagave të magjistratëve/ Drejtoresha e Thesarit, Elmira Peto merret në pyetje nga SPAK

Aktualitet

18 Shtator 2026, 08:47

Aktualitet

18 Shtator 2026, 08:45

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 111-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

Foto ilustruese TIRANA- Qytetarët do të mblidhen sot në protestën e 111-të radhazi kundër qeverisë Rama. Pë...

"Mrekullia" e eksporteve zgjat vetëm një muaj, fasoni rënie e pandalshme, zbret në grupin e dytë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:32

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:21

"Taksë e fshehtë" mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:12

Kushte atmosferike të qëndrueshme, parashikimi i motit për sot

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:09

MË SHUMË



Pagat e magjistratëve/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë

Rama për pagat e magjistratëve: Askush nuk mund t'i diktojë Kuvendit kur të mblidhet

Rama: Lëvizjet e koordinuara mes shoqatave dhe gjyqësorit dëmtojnë Republikën e Shqipërisë

"SPAK dhe GJKKO janë dy suksese të reformës në drejtësi"/ Rama: KLP dhe KLGJ kanë falimentuar

Pagat e magjistratëve/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MBUNDËSHIAR NGA Mediodesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.